



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË

Numri i lëndës: 2021:171517

Datë: 08.05.2024

Numri i dokumentit: 05662484

C.nr.819/2021

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-DEGA NË SUHAREKË, Departamenti i përgjithshëm – Divizioni civil, nga Gjyqtari Robert Tunaj, me bashkëpunorën profesionale Mirvedete Bekteshi, në çështjen juridike civile sipas padisë së paditësve I.U, SH.G, F.Z, H.B, dhe SH.RR, të gjithë mësimdhënës në SHMT “Skender Luarasi” në S, të cilët me autorizim i përfaqëson Av. Z. H nga P Rr”Garibaldi”nr.13/8, ndaj të paditurës K së S, D së A, përfaqësuar nga A. B, me akt emërim, për shkak të kompensimit në emër të kualifikimit – licencimit, vlera e kontestit e pa përcaktuar, me dt.08.05.2024, bie këtë:

A K T G J Y K I M
Pa shqyrtim kryesor

I. APROVOHET PJESËRISHT e bazuar kërkesëpadia e paditësve I. U, Sh. G dhe F. Z, të gjithë mësimdhënës në SHMT “Skender Luarasi” në S. K. S.

II. DETYROHET e paditura K e S – D. K e A, që paditësve për periudhën 03.08.2018 deri me 31.12.2022 për 53 muaj ti paguaj ;

- **I. U** - në emër të kompensimit të kualifikimit - licencimit prej 27% të pagës bazë $459 \times 27\% = 123.93 - 82.55$ diferenca prej 41.38 euro, nga data 03.08.2018 deri me 31.12.2022, për 53 muaj t’ia paguaj shumën e përgjithshme prej **2.193,14 euro** .

- **Sh. G** - në emër të kompensimit të kualifikimit - licencimit prej 27% të pagës bazë $459 \times 27\% = 123.93 - 82.55$ diferenca prej 41.38 euro, nga data 03.08.2018 deri me 31.12.2022, për 53 muaj t’ia paguaj shumën e përgjithshme prej **2.193,14 euro**

-**F.Z** - në emër të kompensimit të kualifikimit - licencimit prej 27% të pagës bazë $459 \times 27\% = 123.93 - 82.55$ diferenca prej 41.38 euro, nga data 03.08.2018 deri me 31.12.2022, për 53 muaj t’ia paguaj shumën e përgjithshme prej **2.193,14 euro** si dhe kamatëvonesën në vlerën prej 8% nga dita e parashtrimit të padisë 03.08.2021 e deri në pagesën definitive.

III. Refuzohet pjesa tjetër e kërkesëpadisë sa i përket kompenzimit të licencimit prej datës 18.04.2017 deri me datë 02.08.2018, **si e parashkruar**.

IV.OBLIGOHET e paditura që paditësit t’ia paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës dhe atë;për përpilimin e padisë 624 euro, për precizimin e padisë 624 Euro si dhe taksën gjyqësore në shumën 21 euro, në total shumën 1248 euro sipas TOAK-së, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

V. Konstatohet e tërhequr padia e paditësve Hasan Balaj dhe Shyqeri Rraqi .

A r s y e t i m

Paditësit I. U, Sh. G ,F. Z, H. B dhe Sh. Rr, të gjithë mësimdhënës në SHMT “Skender Luarasi” në S, të cilët me autorizim i përfaqëson Av. Zahir Hamza nga P Rr”Garibaldi”nr.13/8, me datën 21.04.2021 kundër të paditurës K e S – D e Arsimit për pagesën e kompensimit kualifikimit – licencimit, sipas Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, Me parashtresën e datës 22.11.2023 i autorizuari i paditësve ka bërë precizimin përfundimtar të kërkesëpadisë, me të cilën është tërhequr nga nga padia për paditësit H. B dhe Sh. Rr, pasi që të njëjtëve nuk i takon pagesa për licencim meqenëse janë punëtor teknik në këtë shkollë.

E paditura përmes përgjigjes në padi të dt. 27.10.2023 e ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë me arsyetimin se paditësit në mënyrë individuale kanë nënshkruar një kontratë të punës në të cilën janë paraparë të drejtat dhe detyrimet, në mesin e tyre edhe paga, andaj të gjitha obligimet që dalin nga kontrata e punës e paditura i ka përmbushur në tërësi, duke përfshirë edhe gradimin të përshkruar si në kontratë. Tutje ka shtuar se licenca e tyre është e pavlefshme pasi afati i vlefshmërisë ka skaduar si dhe ka shtuar se një pjese e kërkesës është parashkruar.

Gjykata pas vlerësimit të shkresave të lëndës, konkretisht provave materiale të bashkangjitura padisë, e në kuptim të nenit 8 të Ligjit Për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar dhe vlerësuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha së bashku dhe ka gjetur se: Kërkesëpadia e paditësve është pjesërisht **e bazuar**.

Në nenin 7 par. 1 i Ligjit të procedurës kontestimore parashihet që: “Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla.”

Në nenin 143 paragrafin 1 të Ligjit të procedurës kontestimore parashihet që: “Me aktgjykim gjykata vendos mbi kërkesën që ka të bëjë me çështjen kryesore dhe me kërkesat aksesore.” Nga analizimi i përgjigjes në padi rezulton fakti se e paditura e ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve me arsyetimin se e paditura i ka përmbushur të gjitha obligimet që i takojnë me kontratën e punës duke përfshirë edhe gradimin, dhe se licencës së paditësve i ka skaduar afati, po ashtu edhe kërkesës. Mirëpo gjykata pas analizimit të kontratës së punës të lidhur mes ndërgjyqësve, ka konstatuar se licencimi është paguar vetëm pjesërisht nga ana e të paditurës, ndërsa nuk ka paguar edhe pjesën tjetër të obligimit në bazë mujore. Ndërsa sa i përket pretendimit të të paditurës së licencës i ka skaduar kontrata, pas shikimit të shkresave të lëndës, gjykata ka gjetur se vetë e paditura e ka marr në punë paditësen me kualifikimet që i ka poseduar në atë kohë që nënkupton se e njëjta i ka plotësuar kriteret përkatëse për tu caktuar mësimdhënëse e lëndës përkatëse, dhe nuk e ka larguar nga puna pavarësisht se licenca i ka skaduar andaj konsideroj se ndaj të njëjtëve ka për obligim t’ia paguaj diferencën e kompensimit të kualifikimit – licencimit.

I autorizuari i paditësve, me rastin e ngritjes së padisë, për kompensimin e kualifikimit – licencimit, i ka bashkëngjitur padisë Listën e pagave, për paditësin e parë kontratën e punës nr.628/15, Diplomën nr. 521, Licencën e mesimdhënësit nr. 100011997, për paditësin e dytë kontratën e punës nr.2027/20, Licencën e mesimdhënësit nr. 100022965, Diplomën me nr.926, për paditësin e tretë kontratën e punës nr.619/19, Licencën e mesimdhënësit nr. 100012169, Diplomën me nr.183, dhe autorizimet.

Bazuar në provat e lartcekur, shihet se kërkesa e paditësve gjen mbështetje të plotë në nenin 7 par.1.3 të Kontratës Kolektive e 18.04.2017, ndërmjet SBASHKU-ut dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të Republikës së Kosovës, siç parashihet se *‘Me licencim fitohet e drejta në punë, avancim, karrierë dhe zhvillim profesional në bazë të legjislacionit të punës në fuqi. Të punësuarve u mundësohet kualifikimi pa shkëputje nga puna sipas legjislacionit në fuqi dhe mbi bazën e kualifikimit dhe të: Mësimdhënës me shkollë normale 10% e pagës bazë, Mësimdhënës me shkollë të lartë pedagogjike dy vjeçare 19% e pagës bazë, Mësimdhënës*

me diplomë fakulteti tri vjeç dhe katër vjeçar 27% e pagës bazë, dhe Mësimdhënës me diplomë 5 vjeçar, magjistraturë/master dhe doktoratë 35% e pagës bazë”.

Gjykata ka vërtetuar se e paditura është e obliguar ndaj paditësve konform nenit 7 dhe 35 par. 5 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të dt.18.04.2017 dhe sipas mendimit juridik, që t’ia paguaj kompensimin licencimin në vlerën 27% dhe 35% deri me datën 31.12.2022, dhe këtë obligim e paditura e ka përmbushur vetëm pjesërisht, andaj vendosi që paditësve t’i kompensohet shuma e papaguar e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata vendosi që t’ia falte besimin provave që kan prezantuar paditësit, edhe konkretisht Listën e pagave, për paditësin e parë kontratën e punës nr. 628/15, Diplomën nr. 521, Licencën e mësimdhënësit nr. 100011997, për paditësin e dytë kontratën e punës nr.2027/20, Licencën e mësimdhënësit nr. 100022965, Diplomën me nr.926, për paditësin e tretë kontratën e punës nr.619/19, Licencën e mësimdhënësit nr. 100012169, Diplomën me nr.183 autorizimet, dhe në bazë të listës së pagës u vërtetua se të njëjtit pagën bazë e kan 459 euro, për licencim nga e paditura është kompensuar vetëm pjesërisht siq është përcaktuar në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi aprovimin e kërkesëpadisë së padisë, është mbështetur në vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 01/33 të datës 29.08.2008, nenin 7 si dhe 35 par. 5 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të dt.18.04.2017, e cila është akt më i lartë se kontrata e punës në mes të paditësit dhe të paditurës, kjo bazuar sipas nenit 4 të Ligjit të Punës, theksohet se hierarkia tek marrëdhënia e punës së pari vlen Ligji i Punës, pastaj Kontrata Kolektive e më pas kontrata në mes të punësuarit dhe punëdhënësit.

Gjykata si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, refuzoi pjesën e kërkesëpadisë nga data 18.04.2017 deri me datë 20.04.2018, për shkak të parashkrimit pasi që sipas Ligjit të Punës, nenit 87 theksohet se, citojmë: *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”.*

Për kamatëvonesë gjykata vendosi konform nenit 382 par. 2 i LMD-së.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale, gjykata e mbështeti në nenin 452.1 të LPK-së.

Vendimi si në pikën V të dispozitivit u morë konform nenit 261 par.1 të LPK-së

Gjykata aktgjykimin e mori në kuptim të nenit 152 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NE PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
C.nr.819/2021, datë 08.05.2024

Gj y q t a r i
Robert Tunaj

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankesë në afat prej **7 ditëve** nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe Gjykatën.